

## Llaç çimentoje me kokrriza shumë të imëta për përfundimin në dysHEME dhe në mure

### Përshkrimi

DUROCRET-DECO FINISH është një llaç i parapërzier me bazë çimentoje i modifikuar me polimer me kokrriza shumë të imëta i i cili nuk përmban përbërës korrozivë, dhe që është i përshtatshëm për përdorim në ambiente të brendshme dhe të jashtme, duke ofruar:

- Sipërfaqe të lëmuar
- Rezistencë ndaj gërryerjes.
- Ngjitje shumë të mirë me nënshtresën.
- Papërshkueshmëri nga uji.
- Resultat të veçantë estetik.

Klasifikohet si llaç PCC R3 për riparime betoni, sipas EN 1504-3 si dhe material llaçi çimentoje CT-C25-F6-AR2, sipas EN 13813.

### Fushat e përdorimit

DUROCRET-DECO FINISH përdoret si llaç çimentoje në shumë raste, si në shkallë, dysHEME, mure dhe për struktura të veçanta si shtrate inkaso, artikuj sanitarë inkaso (lavomane, dushe, etj). Mund të përdoret në shtëpi, hotele dhe në çfarëdo rasti ku kërkohet një estetikë e veçantë (p.sh. aritekturë cikladike).

Përdoret në shtresa të holla (1-3 mm), në shumicën e rasteve si veshja përfundimtare e DUROCRET-DECO dhe DUROCRET-DECO FLEX, që të arihet një sipërfaqe e lëmuar

### Të dhënat teknike

Trajta:	pluhur çimentoje
Ngjyrat:	e bardhë, gri, gri e moka, kroko
Jetëgjatësia në enë:	2 orë në +20°C
Kërkesa e ujit:	6.25-6.50 l/ thes 25 kg
Densiteti i volumit të llaçit të thatë:	1.30 ± 0.05 kg/litër

Densiteti i volumit të llaçit të njomë:	1.80 ± 0.10 kg/litër
Rezistenca në shtypje:	≥ 25 N/mm <sup>2</sup>
Rezistenca në përkulje:	≥ 6.0 N/mm <sup>2</sup>
Përmbajtja në kloride:	0,00%
Ngjitje:	≥ 1.8 N/mm <sup>2</sup>
Kompatibiliteti termik Pjesa1 (50 cikle ngrirje-shkrirje):	≥ 1.8 N/mm <sup>2</sup>
Moduli elastik:	≥ 15 GPa
Rezistenca në gërryerje:	AR2
Ujthithja kapilare:	≤ 0.3 kg·m <sup>-2</sup> ·h <sup>-0.5</sup>
Reagimi ndaj zjarrit:	Euroclass F
Trashësia e zbatimit:	1-3 mm për shtresë

### Udhëzimet e përdorimit

#### 1. Përgatitja e nënshtresës

Sipërfaqja duhet të jetë e pastër, pa pluhur, pa vaj, materiale të lira etj. Para aplikimit të DUROCRET-DECO FINISH në sipërfaqe thithëse, si në muraturë, beton ose suva duhet bërë astarim me astarin akrilik UNI-PRIMER në 1-2 shtresa, në varësi të thithjes të nënshtresës ose me rrëshirën ADIFLEX-B të holluar në raport 1:2 me ujë. DUROCRET-DECO FINISH aplikohet mbas 2-3 orësh, sipas kushteve të motit dhe mbas astari është tharë krejt.

Sipërfaqet prej bord gipsi astarohen me UNI-PRIMER. Pastaj duhet të aplikohet DUROCRET-DECO FLEX si shtresë bazë e përforcuar me rrjetë xhami 160 g/m<sup>2</sup>. Mbas 24 orësh, sipërfaqja e ngurtësuar e DUROCRET-DECO FLEX duhet të astarohet me UNI-PRIMER dhe gjatë kohës që rrëshira është e njomë (fresh on fresh), mund të aplikohet DUROCRET-DECO FINISH.

Sipërfaqet jo thithëse si shtresat e vjetra të pllakave ose mozaiket, duhet të astarohen astarin ISOMAT SUPËRGRUND. DUROCRET-DECO FINISH mund të aplikohet mbas 24 orësh, dhe vetëm po të jetë tharë krejt astari.

## 2. Përdorimi

DUROCRET-DECO FINISH hidhet gradualisht në ujë duke u trazuar vazhdimisht, derisa të krijohet një përzierje uniforme. Produkti aplikohet duke përdorur mallë të lëmuar në trashësi 1-3 mm, në një ose dy shtresa. Mbas tharjes mund të fërkohet me letër zmirili në varësi me sa ë lëmur kërkohet të jetë sipërfaqja.

2-3 ditë mbas plotësimit të aplikimit, dhe me kusht që sipërfaqja është tharë, mund të aplikohen llaqet mbrojtëse.

## Ngjyrosja e DUROCRET-DECO FINISH

DUROCRET-DECO FINISH ofrohet në 6 ngjyra të parapërziera (e bardhë, gri, gri e çelët, ohër e çelët, moka, e verdhë veze). Gjithashtu mund të ngjyroset me pigmentet inorganike të cilësisë të lartë DECO COLOR. Pigmentet DECO COLOR ofrohen në 10 ngjyra dhe mund të kombinohen për të arritur një numur të pafund ngjyrash. Ekzistojnë 96 kombinime që rekomandohen në mënyrë indikative dhe janë në DECO COLOR SYSTEM me mjaft më shumë nuanca të cila ofrohen në përdoruesi përfundmtar.

## Përdorimi i llakut

Llaçi dekorativ i çimentos mbrohet me përdorimin e llakut prej poliuretani me bazë tretëse VARNISH-PU 2K (gloss ose satin) ose me llakun prej poliuretani me bazë uji VARNISH-PU 2KW (satin-mat). Llaku me bazë uji është ideal për ambiente të brendshme të cilat nuk kanë ajrosje të mirë, sepse është gati pa erë.

VARNISH-PU 2K dhe VARNISH-PU 2KW shtrohen me një ryl në dy shtresa. Shtresa e dytë aplikohet 4-24 orë mbas të parës, me konditën që ajo është tharë.

Konsumi: 70-120 g/m<sup>2</sup> për shtresë.

Për shpërndarje më të mirë të llakut, sygjerohet që mbas zhytjes të rylit në llak, të shtrydhet në govatë dhe pastaj të përdoret për lyerjen e sipërfaqes.

VARNISH-PU 2K (gloss ose satin) në përgjithësi e errëson sipërfaqen. Në rast që kjo nuk është e dëshirueshme, rekomandohet kombinimi i dy laqeve në mënyrën e mëposhtme:

Fillimisht, aplikohet llaku akrilik me bazë uji VS-W (i holluar me ujë 1:1) në një shtresë me konsum 150-200 ml/m<sup>2</sup>.

Pas 24 orësh, aplikohet llaku poliuretani VARNISH-PU 2K (gloss ose satin) në dy shtresa. Shtesa e dytë aplikohet 4-24 orë pas të parës, me konditën që ajo është tharë.

Përdorimi i VS-W ndihmon që llaçi dekorues prej çimento të mos errësohet nga VARNISH-PU K.

## Konsumi

Rreth 1.4 kg/m<sup>2</sup>/cm të trashësisë së shtresës.

## Amballazhimi

Thasë 25 kg.

## Magazinimi

Të paktën 12 muaj nga data e prodhimit në thasë të mbyllur, në vende të mbrojtura nga lagështia dhe ngrica.

## Shënime

- Në vënd të UNI-PRIMER, mund të përdoret FLEX-PRIMER ose rrëshira ADIFLEX-B, e holluar me ujë (1:2)
- Temperatura gjatë aplikimit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +30°C.
- Gjatë verës rekomandohet të meren masat e nevojshme për të mbrojtur DUROCRET-DECO FINISH nga humbja e ujit si rezultat i temperaturave të larta.

# DUROCRET-DECO FINISH



- Produkti përmban çimento dhe reagon si alkalin me ujin, kështu që ai klasifikohet si irritues.
- Shikoni rreziqet e përdorimit dhe këshillat për sigurinë që janë të shkruara mbi thes.

<b>ISOMAT S.A.</b> 17 <sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece <b>13</b>
EN 1504-3 Concrete repair product for structural repair PCC mortar (based on hydraulic cement, polymer modified) DoP No.: DUROCRET-DECO FINISH/1218.1504-04 Compressive strength: class R3 Chloride ion content: $\leq 0.05\%$ Adhesion: $\geq 1,5$ MPa Carbonation resistance: Pass Elastic modulus: $\geq 15$ GPa Thermal compatibility part 1: $\geq 1,5$ MPa Capillary absorption: $\leq 0.5 \text{ kg}\cdot\text{m}^{-2}\cdot\text{h}^{-0.5}$ Dangerous substances: comply with 5.4 Reaction to fire: Euroclass F

<b>ISOMAT S.A.</b> 17 <sup>th</sup> km Thessaloniki – Ag. Athanasios P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece <b>15</b>
<b>EN 13813 CT-C25-F6-AR2.</b> DoP No.: DUROCRET-DECO FINISH /1218.13813-04 Cementitious screed material for use internally in buildings Reaction to fire: Euroclass F Release of corrosive substances: CT Water permeability : NPD Water vapor permeability: NPD Compressive strength: C25 Flexural strength: F6 Wear resistance: AR 2 Sound insulation: NPD Sound absorption: NPD Thermal resistance: NPD Chemical resistance: NPD

**SOMAT S.A.**  
BUILDING CHEMICALS AND MORTARS  
**ZYRAT QENDRORE – FABRIKA:**  
17th km Thessaloniki - Ag. Athanasios Road,  
P.O. BOX 1043, 570 03 Ag. Athanasios, Greece,  
Tel.: +30 2310 576 000, Faks: +30 2310 722 475  
[www.isomat.eu](http://www.isomat.eu) e-mail: [info@isomat.eu](mailto:info@isomat.eu)

Informacioni teknik dhe udhëzimet e dhëna në këtë fletë të dhënash bazohen në njohurinë dhe në përvojën e Departamentit të Kërkimit dhe të Zhvillimit të kompanisë sonë dhe në rezultatet e dala nga përdorimet afatgjata të produktit në praktikë. Rekomandimet dhe sugjerimet që i referohen përdorimit të produktit jepen pa garanci, meqenëse kushtet e terreneve gjatë përdorimeve të tij janë përtej mundësisë së kontrollit të kompanisë sonë. Si rrjedhojë, përdoruesi është përgjegjës për të konfirmuar se produkti i zgjedhur është i përshtatshëm për përdorimin e parashikuar. Botimi aktual i kësaj flete të dhënash teknike anulon automatikisht çdo botim të kaluar që lidhet me të njëjtin produkt.

